



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:264370  
Datë: 01.10.2024  
Numri i dokumentit: 06238086

**K.DH.SH.II.nr.547/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbaremore të kreditorit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, me seli në rr. “Rilindja”, kati 15, zyra nr. 1503, në Prishtinë, kundër debitorit “Florenti Trans” SH.P.K., me NUI: 811576886, me seli në rr. “Magjistralkja Prishtinë - Mitrovicë”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Fazliu avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.662/23 të datës 27.11.2023, me datën 01.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e “Florenti Trans” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.662/23 të datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.662/23 të datës 27.11.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Florenti Trans” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.43/23, i datës 30.03.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Fazli Gjonbalaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbaremore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës - Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim në bazë të dokumentit përmbartues - Vendimit Nr. 4108/21 të datës 29.09.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit "Florent Trans" SH.P.K., me seli në Vushtrri të cilin e ka detyruar që t'ia paguaj shumën e borxhit prej 5,000.00 €, në emër të masës ndëshkimore si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore, me bllokimin e llogarive bankare, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin si dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, duke theksuar se urdhri përmbartimor është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore. Më tutje ka shtuar se vendimi në bazë të cilit është marrë gjopa është i kundërligjshëm, dhe se i njëjti është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe është bazuar vetëm mbi bazën e vendimit për shqiptimin e gjobave. Ka deklaruar se lënda nuk është trajtuar në përputhje me ligjet përkatëse, për shkak se për të njëjtën çështje është inicuar konflikti administrativ dhe ende nuk ka vendim përfundimtar lidhur me vendimin për shqiptimin e gjobës. Në fund ka theksuar se objekti i urdhrin përmbartimor është i paqartë, i pasaktë dhe si i tillë nuk mund të trajtohet në procedurën përmbartimore. Gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhrin përmbartimor.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimit ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.662/23 të datës 27.11.2023, me të ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit "Florenti Trans" SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.43/23, i datës 30.03.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se Vendimi Nr. 4108/21 i datës 29.09.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 dhe 2 të LPP-së, ngase i njëjti, është bërë i formës së prerë me datë 20.03.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 20.03.2023.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi Nr. 4108/21 i datës 29.09.2021, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është ne pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 te LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi Nr. 4108/21 i datës 29.09.2021, është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 20.03.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë te paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative, te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.547/24 me datë 01.10.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**